



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.14, datë 20.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME (SANITARE), TË SUBJEKTIT “..TE BIRRA STELA” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS KM 7, KASHAR, MËZEZ, TIRANË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “..te Birra Stela” sh.p.k, “Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme (sanitare), me vendndodhje, autostrada Tiranë-Durrës km 7, Kashar, Mëzez, Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X=478861.9;

Y=4580237.9;

Z=56 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar:  $Q=1$  l/sek  
Thellësia e pus-shpimit: 300 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 100m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

-X=478641.2;      Y=4580171.6;      Z=65 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

-X=478561.3;      Y=4580220.9;      Z=56 m.m.n.d

Trupi ujqor pritës: Lumi i Lanës

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

